

**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSELDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

26/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/691

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Zborc

E enjte, më 13 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: SHF "Abdullah Shabani"

Vendi i takimit: 18:30 – 19:25

Pjesëmarrës në takim ishin: Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë Për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi – Gojart Bajrami, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Besnik Ahmeti si dhe Asambleisti Besnik Seferi.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Ky takim ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, ne sot jemi këtu së bashku më drejtorinë e financave Besnik Ahmeti, asistenten Gentianën e cila sot do të mbajë procesverbalin dhe do t'i shkruaj kërkesat e juaja, në krahun tim të djathtë është Besnik Seferi, Shefi i grupit Parlamentar të Levizjes Vetëvendosje, si dhe Drejtori i Shërbimeve Publike Bardhyl Rushiti.

Sot ne jemi këtu që në vija të trasha të shpalosim projekcionet buxhetore për vitin 2025 dhe në të njëjtën kohë t'i marrim kërkesat e banorëve të fshatit Zborc aty ku ata kanë nevojë për investime. Fat i mirë është që në Komunën e Shtimes çdo vit po ka rritje të buxhetit do të thotë këtë vit parashihet dikun afér 1 milion euro me qenë buxheti më i madh se vitin e kaluar.


Ky buxhet ndahet në disa kategori, mirëpo ne sot këtu jemi që të flasim më shumë për investimet kapitale, për këto investime është ndar buxheti 2 milion e 600 mijë, ju e dini dhe po e shihni ne po mundohemi që të sjellim edhe buxhet shtesë nga ministrit e linjës dhe nga Qeveria Kurti me projekte pak më të mëdha se sa janë nevojat dhe kërkesat e qytetarëve. Po sot ne jemi këtë që të marrim prioritete e fshatit Zborc dhe t'i vendosim në kornizën afatmesme buxhetore për vitin 2025.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- Ismet Sadiku: Salla e edukatës fizike a do të përfundojë këtë vit? Po ashtu Shkolla duhet të rregullohet nga brenda, ndriçimi i fshatit nga shkolla në të gjithë fshatin. A planifikohet të zgjerohet rruga për në Carralevë dhe për në Pjetershticë.
- Idriz Mehmeti: Nga shkolla të rregullohet trotuari për shkak të nxënësëve të cilët vin në shkollë. Tek lagjia “Qëndresa”, ndriçimi të vazhdohet, dmth të përfundoj i téri (Nga rruga “Sadri Badra”, deri tek shkolla 300m) .
- Arsim Kadrija: Dy pengesa të vendosen për shkak të shpejtësisë së automjeteve. Të ndahet një parcelë nga zona e pylltarisë për varreza. Të bëhet një sallon i të pameve, po ashtu ne si fshat kemi nevojë edhe për një fushë të futbollit, gjithashtu edhe një park.
- Mehdi Dauti: Në lagjen “Gjinofc”, rryma nuk është në nivelin e duhur, jemi të rrezikuar nga rryma. Transporti për nxënësit. Në rrugën “Sokol Dauti”, trotuari duhet të rivitalizohet. Rruga “Sodllarit” duhet të bëhen disa rrugë të arave.
- Ismajl Sadiku: Në rrugën “Izri Sadiku”, 25 metra të rivitalizohet asfalti nga fundi i rrugës.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Zborc

Date: 13/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Ismet Sadiku	
2	Argim Mladrija	
3	Tanirz Mehmeti	
4	Shaban Bishimi	
5	Gresa Bishimi	
6	Muhamed Qeriqi	
7	Vadjet Lahi	
8	Artim Bishimi	
9	Sabri Kurti	
10	Srajil Sadoiku	
11	Mehmet Dauti	
12		
13		
14		
15		
16		
17		